



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VORË
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM Nr.31

Datë 11/09/2025

**MBI MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE
2025-2028 NË BASHKINË VORË**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 'Për vetëqeverisjen Vendore', Ligjit nr.9355, date 10.03.2005 'Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore' i ndryshuar ; Ligjit Nr.121/2016, date 24.11.2016 'Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë', Ligjit Nr.9970, date 24.07.2008 'Për barazinë gjinore në shoqëri' në mbështetje të Urdhërit Nr.4134 datë 04.09.2025 " Për një ndryshim në urdhërin Nr.68 datë 29.07.2025 mbi ngritjen e grupit të punës për hartimin e planit vendor të veprimit për barazinë gjinore" dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimit Social, me propozim të Kryetarit Të Bashkisë, Këshilli Bashkiak Vorë pasi shqyrtoi dhe analizoi projekt-vendimin :

VENDOSI

- 1-Miratimin e Planit Vendor të Veprimit të Barazisë Gjinore 2025-2028 në Bashkinë Vorë, bashkangjitur.
- 2-Ngarkohen të gjitha drejtoritë e Bashkisë Vorë dhe Kryetari i Bashkisë për zbatimin e këtij vendimi.
- 3-Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, 'Për vetë-qeverisjen vendore, i ndryshuar.

KRYETARE KËSHILLIT

EMIRLANDA ÇELA





BASHKIA VORË

**PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË
GJINORE 2025-2028**

**Përgatitur nga Bashkia Vorë në
kuadër të zbatimit të
Kartës Evropiane për Barazi
Gjinore në jetën vendore**

2025



LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE	3
I. HYRJE	4
II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL.....	7
III. METODOLOGJIA	9
IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË.....	11
V. RAPORTIMI DHE MONITORIMI	20



LISTA E SHKURTIMEVE DHE AKRONIMEVE

AGK	Aleanca e Grave Këshilltare
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DAKS	Drejtoria e Arsimit, Kulturës dhe Sportit
DIRR	Drejtoria e Infrastrukturës Rrugore
DHBGJ	Dhuna me Bazë Gjinore
DHF	Dhuna në Familje
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisiplinar (për rastet e dhunës në familje)
EU GAP III	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore i Bashkimit Evropian III
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial (për rastet e abuzimit të fëmijëve)
KB	Këshilli Bashkiak
KBGJ	Komisioni për Barazinë Gjinore
KBRE	Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve të Evropës
KVDH	Koordinatorë/Koordinator Vendor kundër dhunës në familje
LGBTI+	Persona lezbike, gej, biseksualë/e, transgjitorë/e, transseksualë/e, interseks dhe cilëndo persona të tjerë orientimi seksual dhe/ose shprehja e identitetit gjinor të të cilëve/ave është i ndryshëm nga heteroseksualët/et.
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NBGJ	Nëpunëse/Nëpunës i Barazisë Gjinore
NJA	Njësi Administrative
NJVV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OS	Objektivi Specifik
PVVBGJ	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
SAMPK	Spektori i Administrimit e Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave
SB	Spektori i Buxhetit
SBNJ	Spektori i Burimeve Njerëzore
SECS	Spektori i Emergjencave Civile dhe Strehimi
SIT	Spektori i Informacionit dhe Teknologjisë
SJ	Spektori Juridik
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030)
SKIENHT	Spektori për Koordinimin e Integritit Evropian, Ndihmës së Huaj dhe Turizmit
SKNJA	Spektori i Koordinimit me Njësitë Administrative
SMS	Spektori i Mbrojtjes Sociale
STTIT	Spektori i Tatim-Taksave dhe Inspektoriati Tatimor
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak



I. HYRJE

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2025 – 2028 u përgatit nga Bashkia Vorw, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, duke u bazuar te Karta Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore¹. Ky plan veprimi u hartua përmes një procesi ndërveprues dhe gjithëpërfshirës, në bashkëpunim dhe konsultim me institucionet publike vendore, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, median, bizneset, Këshillin Rinor, Aleancën e Grave Këshilltare dhe antarë të Këshillit Bashkiak e Komisionit të Barazisë Gjinore, pjesë e këtij Këshilli.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë afësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipet gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. (UN Women, 2011)

Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave. (UN Women, 2011)³

Sikurse përshkruhet edhe në tekstin e Kartës Evropiane për Barazi, njësitë e vetëqeverisjes vendore janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Këto mund të arrihen duke ndërthurur zbatimin e kompetencave të tyre me bashkëpunimin me të gjithë gamën e aktorëve vendorë, për veprime konkrete në favor të barazisë ndërmjet grave dhe burrave⁴, të rejave dhe të

¹Teksti i Kartës në gjuhën shqipe mund të aksesohet në:

https://www.ccre.org/img/uploads/piecesjointe/filename/charte_egalite_al.pdf

² Për më shumë informacion mbi Këshillin e Bashkive dhe Rajoneve të Evropës, vizitoni:

https://www.ccre.org/en/article/introducing_cemr

³ Për një listë më të plotë me koncepte mund të vizitoni edhe: <https://eige.europa.eu/thesaurus/browse>

⁴“Gra dhe burra” në këtë PVVBGJ nënkupton periudhën moshore duke filluar nga mbi 35 vjeç, deri në fund të jetës (përfshirë edhe të moshuarat/moshuarit).



rinjve⁵, vajzave dhe djemve⁶. Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes vendore.

Me gjithë përpjekjet e bëra apo që vijojnë të bëhen ndër vite në këtë drejtim, si dhe plotësimin e harmonizimit e kuadrit ligjor dhe të politikave vendore me ato kombëtare e ndërkombëtare, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Pabarazitë dhe diskriminimi apo disavantazhimi i shumëfishtë, jo vetëm ndërmjet gjinive por edhe ndërmjet grupeve brenda të njëjtës gjini, vijojnë të mbështeten në një sërë nocionesh shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipeve të shumta të pranishme në familje, arsim, kulturë, komunikim, botën e punës, në organizimin e shoqërisë, etj.

Prandaj, nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes vendore të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikat, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është gjithashtu dhe tipar kryesor që ndikon dhe në situatën tonë ekonomik dhe shoqëror.

Kryetari i Bashkisë Vorw ka ndërmarrë një angazhim publik për të hedhur hapa konkretë dhe të duhur për bërjen realitet të barazisë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve të Vorës, pavarësisht moshës, (pa) aftësisë, etnisë, vendbanimit, statusit ekonomik e të punësimit, besimit fetar, identitetit gjinor e orientimit seksual, apo çdo karakteristike tjetër individuale e shoqërore. Karta Evropiane për Barazi nënkupton gjithashtu përdorimin e saj si një instrument i rëndësishëm që do të orientojë veprimet dhe hapat që do të ndërmerren në të gjitha aspektet e jetës ku bashkia investon. PVVBGJ 2025-2028 është konceptuar dhe lidhur logjikisht me nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, me kuadrin ligjor dhe të politikave kombëtare, si dhe instrumentat kryesorë ndërkombëtarë të ratifikuar nga shteti shqiptar lidhur me barazinë gjinore..

Procesi gjithëpërfshirës i përgatitjes së PVVBGJ 2025 – 2028 synonte dhënien e mesazhit të bashkëpunimit dhe koordinimit të veprimeve institucionale, pasi asnjë ndërhyrje e bërë me sado kujdes dhe burime në dispozicion, nuk mund të jetë e suksesshme nëse ndërmerret nga një institucion i vetëm. Gjithashtu, suksesi në arritjen e rezultateve të dëshiruara vjen vetëm nëse merren në konsideratë dhe adresohen siç duhet e në mënyrë të barabartë, nevojat e ndryshme të grave e burrave, të rejave e të rinjve, vajzave e djemve pra të të gjithë anëtareve dhe antarëve të komunitetit. Megjithatë, fuqizimi i grave, të rejave e vajzave mbetet një ndër synimet kryesore, për përmbushjen e objektivave të barazisë gjinore. Për të shprehur sa më

qartë domosdoshmërinë e gjithëpërfshirjes, në të gjithë tekstin në vijim në këtë PVVBGJ, është përdorur në mënyrë të vazhdueshme shprehja **“nga të gjithë grupet”** që të theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të të gjithë individëve, e në mënyrë të veçantë të grave, të rejave dhe vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cënueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuar, të moshuara, migrante, azilkërkues.

II. KUADRI LIGJOR DHE INSITUCIONAL

Kur flasim për kuadrin ligjor dhe të politikave në fushën e barazisë gjinore, duhet të kemi parasysh që e drejta për barazi ndërmjet gjinive buron që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 18), që është edhe dokumenti ligjor më i lartë në hierarkinë ligjore të vendit. Nën nenin 18 të kushtetutës qartësohet shprehimisht se: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit; 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore; 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive.”*. Kjo barazi de-jure është gjithashtu e shprehur edhe në një tërësi instrumentash ndërkombëtarë, të cilët kur ratifikohen nga Parlamenti shqiptar, zenë vend në hierarkinë ligjore të vendit menjëherë pas Kushtetutës, çfarë nënkupton që nëse për një çështje të caktuar nuk ka një parashikim të qartë në legjisllacionin vendas, atëhere për zgjidhjen e saj u drejtohem parashikimeve në instrumentat ndërkombëtarë të ratifikuar.

Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2028 përveçse si një instrument i zbatimit të Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, mbështetet në një tërësi dokumentash të rëndësishëm ligjorë dhe institucionalë, të cilët udhëheqin njëkohësisht edhe veprimet mbarëkombëtare për fuqizimin e gruas dhe avancimin drejt barazisë gjinore në Shqipëri. Si më kryesoret mund të përmendim:

a) Instrumente ndërkombëtarë

- Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe burrave në jetën vendore (EU Charter for Equality)⁸.
- Konventa për Eliminimin e të gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW).
- Deklarata dhe Platforma për Veprim e Pekinit (BDPfA).
- Konventa e KE për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).

rastet kur këto organizata financohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nga bashkia, apo janë angazhuar për zbatimin direkt të një aktiviteti përmes një marrëveshjeje me bashkinë dhe e kanë të siguruar burimin financiar për këtë qëllim.

⁸ E renditur në krye të kësaj liste për shkak të rëndësisë që ka në nivelin vendor në lidhje me vetë përgatitjen e këtij PVVBGJ. Ndonëse ky dokument nuk është i ratifikuar nga shteti shqiptar, sepse nuk



, ka një procedurë të tillë, pjesëmarrja në të bëhet nëpërmjet nënshkrimit nga ana e vetë bashkive.

- Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm (OZHQ).
- Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian dhe Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj.

b) Kuadri ligjor kombëtar

- Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri".
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore".
- Ligji Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
- Ligji 125/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar⁹.
- Ligjin 124/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.221/04.02.2010 për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar.
- Ligji nr. 35/2020 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 136/2015 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara".
- Ligji Nr.104/2014 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 101/2020 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji 65/2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".
- Ligji 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur".
- Ligji 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti".
- Ligji 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.03.1995, "Kodi i Procedurës Penale", i ndryshuar.
- Ligji nr. 79/2017 "Për sportin".
- Ligji 22/2018 "Për strehimin social".
- Ligji 15/2019 "Për nxitjen e punësimit".
- Ligji nr. 75/2019 "Për rininë", etj.

c) Politikat kombëtare

Të gjitha masat dhe veprimet e parashikuara në këtë PVVBGJ 2025 – 2027 kuptohet që mbështeten edhe në strategjitë apo planet kombëtare të veprimit që mbulojnë sektorët (drejtoritë) e caktuara sipas fushave të tyre. Por politika kryesore kombëtare mbi të cilën bazohet ky PVVBGJ është Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030.



⁹ Së bashku me Ligjin Nr. 47/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006
"Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar, si dhe me të gjithë ndryshimet e
mëparshme që ka pësuar ligji bazë Nr. 9669/2006.



d) Institucionet përgjegjëse

Siç përshkruhet edhe në Kartën Evropiane për Barazi, përgjegjës kryesorë për zbatimin e kësaj Karte përmes përgatitjes dhe zbatimit të PVVBGJ, janë bashkitë. Në mënyrën se si është ndërtuar dhe funksionon mekanizmi kombëtar për barazinë gjinore në Shqipëri, në nivel të vetëqeverisjes vendore janë Nëpunëset/Nëpunësit e Barazisë Gjinore (NBGJ) përgjegjës për zbatimin e veprimeve në këtë drejtim, nën koordinimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në Bashkinë Vorë, nuk ka punonjës të emëruar si nëpunës i Barazisë Gjinore (NBGJ). Me fillimin e zbatimit të këtij PVVBGJ pas miratimit në Këshillin Bashkiak, Bashkia do vijojë përpjekjet që në të ardhmen të mund të emëroj një person në pozicionin si Nëpunës i Barazisë Gjinore, për t'i dhënë akoma më shumë përparësi integritetit të perspektivës gjinore në të gjithë fushat ku bashkia vepron.

Rol të rëndësishëm në lidhje me adresimin e çështjeve gjinore, në nivelin vendor luajnë edhe Aleanca e Grave Këshilltare dhe Komisioni për Barazinë Gjinore në nivel të Këshillit Bashkiak. Po kështu me rëndësi është edhe formalizimi i një Komisioni për Barazi Gjinore në nivel bashkie i përbërë nga përfaqësuese dhe përfaqësues të sektorëve përgjegjës për zbatimin e këtij PVVBGJ, të cilat/cilët ishin edhe pjesë e grupit të punës që përgatiti këtë plan. Ky Komision, do të mundësonte një zbatim akoma më të mirë të PVVBGJ-së. Në vijim, të gjithë institucionet vendore dhe OJF të cilat përfshihen si partnere për zbatimin e masave dhe veprimeve kryesore në këtë PVVBGJ, janë gjithashtu të rëndësishme dhe të domosdoshme për të pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë gjinore. Rol të rëndësishëm këtu luajnë edhe organizatat ndërkombëtare nëpërmjet mbështetjes financiare dhe teknike për të zbatuar masa të caktuara të parashikuara në këtë PVVBGJ.



III. METODOLOGJIA

Metodologjia për hartimin e PVVBGJ 2025-2028 ishte gjithëpërfshirëse dhe u zhvillua përmes hapave në vijim:

- **Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues (desk review).** Kjo analizë u bazua në një tërësi dokumentash ekzistues apo draft dokumentash të bashkisë, por padyshim që u shtri edhe në tërësinë e kuadrit ligjor dhe të politikave ekzistuese kombëtare e vendore, të lidhura me çështjet gjinore



Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PVVBGJ 2025-2028. Ky përcaktim u bë duke ndjekur një tërësi hapash, që filluan që nga identifikimi i prioriteteve bazuar në desk review të realizuar në fazën e parë, e deri tek marrja në konsideratë dhe reflektimi i duhur i komenteve dhe sugjerimeve të ardhura nga diskutimet me stafin e bashkisë, NJA-të, si dhe nga partnerët dhe bashkëpunëtorët kryesorë të bashkisë (OJF, institucionet vendore, etj).

- ***Konsultimet paraprake brenda bashkisë.*** Këto konsultime u zhvilluan me stafin e bashkisë (përfaqësuese e përfaqësues nga të gjithë sektorët në bashki) dhe administratorët e NJA. Ky hap u konsiderua i domosdoshëm, së pari për të mundur njohjen me Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore. Gjithashtu këto diskutime e lehtësuan mjaft procesin e përgatitjes së draftit të parë të PVVBGJ-së, pasi u ndalën në çështjet kryesore për t'u adresuar përmes përgatitjes dhe zbatimit të këtij PVVBGJ.

- ***Përgatitja e draft dokumentit të PVVBGJ 2025 – 2028.*** Draft i përgatitur për konsultim përmbante seksionet dhe të dhënat kryesore, vizionin, fushat e ndërhyrjes, objektivat specifike dhe masat e veprimet e parashikuara për arritjen e objektivave specifike. Në këtë draft u reflektuan edhe ndryshimet e dakordësuara në konsultimet paraprake brenda bashkisë.

- ***Konsultime me palët e interesuara dhe grupet e interesit.*** Ky proces u zhvillua mbi draft dokumentin e përgatitur. Në konsultime u përfshinë përveç stafit të bashkisë dhe NJA-ve, edhe OJF-të bashkëpunëtoare, institucionet vendore, si dhe antare të Aleancës së Grave Këshilltare dhe të Këshillit Bashkiak.

- ***Finalizimi i draft PVVBGJ 2025-2028 dhe kostimi i veprimeve të dakordësuara.*** Finalizimi i draft PVVBGJ u bë në bazë të komenteve dhe sugjerimeve të marra gjatë konsultimit të tij. Paralelisht u realizua edhe kostimi i aktiviteteve të dakordësuara.

- ***Miratimi i PVVBGJ 2025 – 2028 në Këshillin Bashkiak.*** Versioni përfundimtar i PVVBGJ i konsultuar e kostuar u përcoll për miratim në Këshillin Bashkiak në shtator 2025. Pas miratimit PVVBGJ 2025 – 2028 do të publikohet edhe në faqen e internetit të bashkisë si dhe versioni anglisht i tij do të publikohet në faqen e Këshillit të Bashkive dhe Rajoneve të Evropës (KBRE). Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2025-2028 i Bashkisë Vorë u miratua me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. xx datë xxxxx.2025.

Të gjitha hapat e mësipërm shkojnë në linjë dhe me metodologjinë e përgatitjes PVVBGJ-ve siç sugjerohet nga KBRE¹⁰.



IV. VIZIONI, FUSHAT E NDËRHYRJES DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Vizioni:

“Gratë dhe burrat, të rejtat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë e Vorws, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik e social, aftësive të kufizuara e nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor, statusit civil, të migrantës/migrantit e azilkërkueses/azilkërkuesit, statusit të punësimit e gjendjes ekonomike, përkatësisë fetare, apo karakteristikave të tjera individuale, njohin, gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimin e saj në praktikë, në të gjitha fushat e jetës”.

Parimet¹¹ që udhëheqin zbatimin e PVVBGJ, janë të njëjtat parime që udhëheqin në tërësi zbatimin e Kartës Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore, siç paraqiten në vijim:

¹⁰ Për më shumë shiko në: <https://charter-equality.eu/the-action-plan-step-by-step/definir-un-plan-daction-en.html>

¹¹ Për shpjegime më të hollësishme mbi secilin parim, mund të referoheni tek teksti i Kartës Evropiane për Barazi në adresën: https://ccre-cemr.org/wp-content/uploads/2024/03/charte_egalite_al.pdf

1. Barazia ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjithë grupet përbën një të drejtë themelore.
2. Për të siguruar barazinë gjinore duhet të trajtohen çështjet e diskriminimit dhe të pengesave të shumëfishta.
3. Pjesëmarrja e balancuar e grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve në vendimmarrje është parakusht për një shoqëri demokratike.
4. Eliminimi i stereotipeve gjinore ka rëndësi themelore për arritjen e barazisë gjinore.
5. Integrimi i këndvështrimit gjinor në të gjitha veprimtaritë e organeve të vetëqeverisjes vendore është i nevojshëm për të çuar përpara barazinë gjinore.
6. Planet e veprimit, të mbështetura me burimet e duhura, janë instrumente të nevojshme për çuarjen përpara të barazisë gjinore.

Fushat kryesore të ndërhyrjes.

PVVBGJ 2025 – 2028 përbëhet nga katër fusha kryesore të ndërhyrjes, të cilat jo vetëm kanë në përmbajtje nene të ndryshme të Kartës Evropiane për Barazi, por janë harmonizuar edhe me një pjesë të objektivave specifike të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 - 2030, sidomos ato që përmbajnë masa dhe veprime specifike ku përgjegjës kryesorë për zbatim janë NJVV-të. Këto fusha ndërhyrjeje janë:

- I. Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore.
- II. Zvogëlimi i stereotipeve gjinore, praktikave të dëmshme, diskriminimit dhe disavantazhimit të shumëfishtë.
- III. Përparimi drejt punësimit dhe zhvillimit ekonomik të ekuilibruar dhe të qendrueshëm.
- IV. Rritja e nivelit të sigurisë, mbrojtjes dhe eficensës së qasjes shumë-sektoriale të koordinuar për gratë, të rejtat, vajzat si dhe burrat, të rinjtë e djemtë, në hapësirat publike e private.

Secila nga këto fusha të ndërhyrjes është zbërthyer më tej në rezultatet e pritshme, objektivat specifike, treguesit e matjes së tyre, si dhe në masa e veprime konkrete, të cilat detajohen në matricën e planit të veprimit, ku jepet një informacion më i plotë si për zbatimin dhe vlerësimin e rezultateve, ashtu edhe përsa u përket neneve specifike të Kartës Evropiane, si dhe dokumentave të tjerë kryesorë ku mund të referohemi në përmbushje të veprimeve të parashikuara nën secilën fushë ndërhyrjeje.

Përparimi dhe efektiviteti në zbatimin e PVVBGJ kërkon domosdoshmërisht vënien në dispozicion të burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme njerëzore, financiare e infrastrukturore, si dhe koordinimin e veprimeve dhe bashkëpunimin ndër-institucional me institucionet e tjera vendore, organizatat e shoqërisë civile, si dhe organizatat ndërkombëtare të cilat punojnë për fuqizimin e grave dhe arritjen e barazisë gjinore. Mbledhja dhe përditësimi rregullisht i të dhënave të ndara jo vetëm sipas seksit, por edhe sipas një tërësie karakteristikash të tjera individuale, monitorimi i vazhdueshëm mbi ecurinë e zbatimit të veprimeve të parashikuara, si dhe transparencja e

Ilogaridhënia për rezultatet e arritura, janë gjithashtu domosdoshmëri për të avancuar drejt vizionit që udhëheq këtë PVVBGJ.

Monitorimi dhe Raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore 2025—2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, dhe të bazuar në të dhëna.

6.1 Monitorimi dhe Raportimi

Zbatimi i Planit Vendor të Veprimit për **Barazine Gjinore 2025—2028** do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi i, që siguron:

1. Ndjekje në kohë reale të progresit;
2. Evidentim të shpejtë të sfidave;
3. Përmirësim të vazhdueshëm të veprimeve.

6.2 Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:

- i strukturuar, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- i bazuar në tregues të matshëm, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktoreve jo publikë, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

6.3 Aktorët përgjegjës

- Koordinatori për barazinë gjinore do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave.
- Komisioni për Barazinë Gjinore në Bashki (**KBGJ**) do të ndjekë progresin



në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.

- Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

6.4 Treguesit e progresit

Për secilin aktivitet në *plan* janë përcaktuar tregues të qartë ei: numri i trajnimeve të realizuara, pjesëmarrja gjinore numri i aktiviteteve , numri i strukturave të ngritura, përfshirja e komunitetit në konsultime, etj. Treguesit janë ndarë sipas gjinisë dhe, aty ku është e mundur, sipas grupmoshës, nivelit arsimor, punësimit, statusit martesor r dhe zonës (urbane/rurale).

6.5 Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- Çdo 6 muaj, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës gjinore, që do të përdoret nga të gjitha drejtorit dhe njësitë administrative.
- Çdo vit, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do të prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.
- Raporti vjetor do të përbëjë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

6.6 . Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.



PLANTVENDOR I VEPRIMIT PERBARAZINE GJINORE 2025 - 2028

1. Plani i Veprimit (matrica e aktiviteteve)

Qellimi strategjik I:

Forcimi i qeverisjes vendore permes institucionalizimit te barazise gjinore si parim themelor ne do proces vendimmarrjeje, planifikimi dhe raportimi publik.

Objektivi Specifik (01.1) Te krijohet nje sistem i qendrueshem, transparent dhe periodik raportimi publik mbi progresin dhe angazhimet e Bashkise per barazine "inore, permes perdorimit te te dhenave gjinore, oflatformave digitale dhe perfshijs gytetare.

Aktivitetet	Periudha e zbatimit	Pergjegjes	Partnere	Burimet financiare	Tregues
1.1.1 Publikimi i Planit te Veprimit ne fagen e internetit te bashkise dhe te KBRE-se.	2025	Drejtoria e medias teknologjis dhe inovacionit	Sekretariati i Keshillit Bashkiak, Komisioni i keshillit bashkiak per barazine gjinore, aleanca e grave keshilltare	Bashkia Vorë	Plani i publikuar dhe qasja publike ne fagen zyrtare
1.1.2 Hartimi i udhezimeve dhe tabelave te treguesve per monitorim.	2025	Sektori i informimit dhe monitorimit te performances	Sektori i informimit dhe monitorimit te performances	Bashkia Vorë	Dokument i perfunduar dhe shpendare ne drejtorite perkatese
1.1.3. Njohja me instrumentet matese per mbledhjen e te dhenave.	2025	Drejtoria e burimeve njerezore	INSTAT, donatore	Bashkia Vorë	Numri i punonjeseve te njohur me instrumentat matese per mbledhje e te dhenave.



1.14. Trajnim per punonjesit mbi mbledhjen e te dhenave me tregues gjinore.	2025 - 2028	Drejtoria e burimeve njerezore	INSTAT, donatore	Bashkia Vorë	Numri i punonjeseve te trajnuar dhe vleresimi pas-trajnit
---	-------------	--------------------------------	------------------	--------------	---



1.1.5 Krijimi i nje platforme online te hapur	2025 - 2028	Drejtoria e medias teknologjis dhe inovacionit	AKSHI, Shogeria Civile	Bashkia Vorë	Platforma funksionale dhe numri i perdoruesve aktive
r publikimin e statistikave dhe konsultime publike per masat per barazine gjinore ne Bashki					
1.4.6 Perfshirja ne rubriken perkatese te seksionit per konsultime publike per buxhetimin dhe nxitjen pjesemartjen gjinore	2025	Drejtoria e menaxhimit financiar dhe programeve te strehimit	Njesite Administrative, Gra Keshilltare	Bashkia Vorë	Seksioni funksional dhe pjesemartje gjinore ne konsultime
1.4.7 Kalendar Lokal dhe organizim iaktiviteve per Diet Nderkombetare te Drejtave te Grave	Viti 2025 (i perseritshem do vit)	Drejtoria e arsimit, shenetesise, kultures, rinise dhe sporteve	Shkolla, OJF lokale, media		Numri i aktiviteve te organizuara sipas kalendarit

1.4.8 Sistem i integruar dixhital per mbledhjen dhe analizen gjimore te te dhenave ne nivel lokal	2025-2028	IT dhe Pergjegjesit/drejtuesit e drejtorive/sektoreve ne bashki	INSTAT, partnere teknike, eksperte te fushes	Sistem funksional, numri te dhenave te perpunuara gjinor
1.4.9. Organizimi i tryezave vijetore te konsultimit me komunitetin dhe	2025 – 2028	Drejtoria e Politikave Sociale, Drejtoria e informimit, integrimit europian, projekteve strategjike dhe monitorimit te performances	Keshilli Vendor per Barazine Gjimore (nese ekziston), Organizata te	Bashkia Vore
				Numri i takimeve te organizuara me komunitetin dhe aktorët lokalë mbi

aktoret lokale mbi progresin e planit dhe te dhenat gjimore te publikuara.			shoqerise civile lokale, Institucionet arsimore dhe grupe te komunitetit	progresin e planit.
1.4.10. Angazhimi i te rinjve, grupeve qytetare dhe OJF-ve lokale mbiqyrjen e			Qendrat komunitare dhe rinore ne territorin e bashkise OJF qe punojne per transparencen,	Numri i grupeve vezhguese te ngritura dhe/os

buxhetimit te ndjeshem gjinor permes "grupeve vezhguese" ose iniciativave per transparence.	2026 - 2028	Zyra per Barazi Gjinore	pjesemartjen qytetare dhe barazine gjinore (p.sh. Qendra per te Drejtat e Grave, Qendra Rinore, etj.) Fakultetet/institucionet arsimore qe kane klube rinore apo departamente te shkencave sociale.	Bashkia Vorë	e aktiviteteve te ndermarra nga te rinjte, grupet qytetare dhe OJF - te monitoruar dhe promovuar buxhetimin ndjeshem gjino r ne nivel vendor.
---	-------------	-------------------------	---	--------------	---

1.4.11. Prezantimi dhe shpendarja e te dhenave gjinore mbi progresin e barazise gjinore, permes platformave digitale dhe kanaleve te tradicionale komunikimit me publikun.	2025 - 2028	Drejtoria e medias teknologjis dhe inovacionit , Drejtoria e informimit, integritetit europian, projekteve strategjike dhe monitorimit te performances Njesite Administrative dhe Qendrat Komunitare	Organizatatave te shogerise civile qe punojne per barazine gjinore dhe pjesemartjen qytetare, Partnereve teknike dhe donatoreve.	Bashkia Vorë	Numri 1 te publikimeve me mbi progresin e barazise gjinore te shpendara ne platforma digitale dhe media tradicionale.
--	-------------	--	--	--------------	---

Objektivi Specifik (01.2) Te forcohen kapacitetet institucionale dhe strukturat organizative te Bashkise per garantimin, koordinimin dhe integrimin e barazise gjinore ne te gjitha funksionet vendore.

Aktivite	Periudha e zbatimit	Pergjegjes	Partner e	Burimet financiare	Tregues
1.2.1 Fugizimi dhe rritja e kapaciteteve te struktures pergjegjese per barazine gjinore ne Bashki (Njesia per barazine gjinore)	2025	Njesia pergjegjese per Burimet Njerezore & Kryetar i Bashkise	Donatore	Bashkia Vorë	Struktura funksionale dhe e pajisur me burime njerezore
1.2.2 Ngritja e funksionalizimi i Komisionit per Barazine Gjinore ne nivel Bashkie.(ekzekutivi)	2026	Kryetari i Bashkis	Drejtesit e Drejtorive, Keshilli Bashkiak	Bashkia Vorë	Komisioni aktiv dhe mbledhje periodike te dokumentuara
1.2.3 Trajnim per anetaret e Komisionit per Barazine Gjinore ne nivel Bashkie. (KBGJ) mbi buxhetimin gjinor.	2026	Nesia pergjegjese per Barazi Gjinore	Donatore, eksperte te kontraktuar	Bashkia Vorë	Numri i trajnimeve dhe perfshirja e anetareve
1.2.4 Program trajnimi per zyrtaret bashkiake mbi barazine gjinore dhe anti-diskriminimin sipas nje kalendari vjetor te miratuar.	2026-2028	Drejtoria e Burimeve Njerezore	Shkolla e Administrate s Publike, OJF	Bashkia Vorë	Numri i trajnimeve te zhvilluara sipas kalendarit vjetor

PLANI VENDOR I VEPRIMIT PER BARAZINE GJINO 2025 - 2028

Objektivi Specifik (01.3) Te nxiet dhe zgjerohet pjesemaria aktive e grave dhe vajzave ne proceset vendimmarrëse, konsultimet publike dhe hapësirat e dialogut me komunitetin, ne nivel lokal.

Aktivite	Periudha e zbatimit	Pergjegjes	Partnere	Burimet financiare	Tregues
1.3.1 Takime informuese me administratorët shqetorë mbi rendesine e pjesemaries ne degjese.	2025	Drejtoria e Politikave Sociale	Njesie Administrative, Njesia pergegjesje per Barazine gjinore ne bashki (punonjesi i barazise gjinore)	Bashkia Vorë	Numri i takimeve dhe pjesemarrësve perfaqësues
1.3.2 Organizimi i fushatave sensibilizuese mbi rolet gjinore ne komunitete rurale dhe lagje urbane	2025-2028	Njesie Administrative, Njesia pergegjesje per Barazine gjinore ne bashki (punonjesi i barazise gjinore)	OJF lokale, shkolla, grupet e interesit	Bashkia Vorë	Numri i fushatave dhe zonat e mbuluara
1.3.3 Organizimi i fushatave te komunikimit gjinor me media lokale dhe shkolla	2025 - 2028	Drejtoria e arsimit, shendetesise, kulture, rrimise dhe sporteve	Media lokale, ZVA Vore, OJF	Bashkia Vorë	Numri i fushatave te zhvilluara ne media dhe shkolla



1.3.4 Organizimi i konsultimeve periodike dhe te rregullta me organizatat e grave dhe grupet ne nevojë per probleme dhe sfida ne ofitimin dhe perfitimimin e sherbimeve publike lokale;	2025 e ne VU Im	Drejtoria e Politikave Sociale	OJF, grupime komunitare, perfaqesues te sherbimeve	Bashkia Vorë	Numri i konsultimeve dhe temat e adresuara ne sherbimet publike
---	-----------------	--------------------------------	--	--------------	---

Qellimi strategjik 2:

Zhvillimi dhe ofrimi i sherbimeve publike gjithepershires, te cilesise se larte dhe te ndjeshme ndaj gjimise, qe adresojne nevojat konkrete te grave dhe burrave ne te gjitha zonat e territorit te Bashkise Kolonje.

Objektivi Specifik (02.1) Te garantohet akses i barabarte dhe territorialisht i balancuar ne sherbime publike cilesore dhe te ndjeshme ndaj gjimise, permes zhvillimit te strukturave vendore, mbeshtetjes ekonomike dhe ndergjeeciesimit komuntar.					
Aktivitetet	Periusha e zbatimit	Pergjegjes	Partnere	Burimet financiare	Tregues
2.1.1 Krijimi dhe funksionalizimi i strukturave te NJVRR (Njesite Vendore te Referimit dhe Reagimit) per cdo njesi administrative	2025	Njesia pergjegjese per Burimet Njerezore & Kryetar i Bashkise	Njesite Administrative, Njesia pergjegjese per barazine gjimore ne bashki (Koordinatori i barazise gjimore)	Bashkia Vorë	Numri i strukturave NJVRR te ngritura dhe funksionale ne njesi administrative

I PLANI VENDOR I VEPRIMIT PER BARAZINE GJINORE 2025-2028

2.1.2 Zhvillimi I nje programi vjetor me mbeshtetjeje financiare me grante te vogla per grate dhe vajzat, qe synojne te nxism iniciativa sociale, ekonomike apo biznese te vogla (ves;anerisht ne zonat rurale). zhvillimi I hapësirave komunitare te dedikuara per Grate dhe Vajzat ne Cdo njesi administrative.	2025-2028	Drejtoria e administrimit menaxhimit dhe mbrojtjes se tokes, Drejtoria e menaxhimit financiar dhe programeve te strehimit per infrastrukturen, sherbimet publike, & ndjekjen e investimeve ne bashki	Ajencia e Zhvillimit Rajonal, Donatore, OJF ekonomike Administrative, Arkitektet, Shogata komunitare	Bashkia Vore	Numri i granteve te dhena; % e perfutuesve nga zonat rurale hapësirave te hapura dhe frekuentimi i tyre.
--	------------------	---	---	---------------------	---




2.1.3 Zhvillimi I Moduleve te ndergjegjesimit mbi barazine gjinore ne bashkepunim me ZVA dhe shkollat fillore konsultimeve dhe hulumtimeve lokale per identifikimin e nevojave, preferencave dhe sfidave ndjeshmerine gjinore dhe ofrimin e sherbimeve te barabarta	2025-2028	Njesia pergjegjese per Barazine gjinore ne bashki (Kordinator i barazise gjinore)	ZVA Vore, OJF edukative, mesues te perzgjedhur	Bashkia Vore	Numri i moduleve te zhvilluara dhe numri i shkollave pjesemarese Numri i konsultimeve dhe hulumtimeve te realizuara ne niveli lokal per identifikimin e nevojave te grave dhe vajzave ne njesite administrative ne menyre qe te hartohen hapesira komunitare qe ofrojne mbeshetje efektive dhe te pershtatura per ta
---	-----------	---	--	--------------	---



Objektivi Specifik (02.2) Te forcohet reagimi institucional shume-sektorial ndaj dhunes me baze gjinore, permes mekanizmeve te koordinuar, qasjeve te ndjeshme gjil l or dhe mbeshtetjes se drejtperdrejte per viktimat ne situata te zakonshme dhe eme ente.

Aktivite	Perjshja e zbatimit	Perjegjes	Partnere	Burimet financiare	Tregues
2.2.1 Hartimi dhe miratimi i nje protokolli te ndjeshem gjinor per reagim ne raste pandemie, fatkeqesi natyrore ose kriza civile	2025	Njesia perjegjese per sherbimet e Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Shendetesise	Njesia perjegjese per sherbimet Sociale; Qendra Shendetesore, OJF, Ministria e Shendetesis	Bashkia Vore	Dokument protokolli i miratuar dhe i shpendare ne strukturat vendore
2.2.3 Ofrimi i sherbimeve psiko- sociale falas per grate dhe vajzat viktima te dhunes dhe diskriminimit gjinor	2025 -2028	Drejtoria e Sherbimit Social te Bashkise Psikologe dhe punonjes sociale te trajnuar ne bashkepunim me partnere te shogerise civile Qendra Sociale	Bashkia Vore		Numri i grave dhe vajzave viktima te dhunes ose diskriminimit gjinor qe kane perfituar sherbime psiko- sociale falas.



Bazuar urdherit te Kryetarit Nr.78, datë 04.09.2025 “ PER NJE NDRYSHIM NE URDHERIN NR.68 DATE 29.07.2025 MBI NGRIJTJEN E GRUPT
TE PUNES PER HARTIMIN E PLANIT VENDOR TE VEPRIMIT PER BARAZINE GJINORE”

Grupi punes bazuar urdherit perbehet nga:

Silvana Koni – Kryetar (Përgjegjës i sektorit te Politikave Sociale)

Erida Locka – Anëtar (Specialist Kordinator Vendor)

Anita Dine – Anëtar (Përgjegjës i programeve të strehimit)

Rovena Kurti- Anëtar- (Specialist personeli)

Elfrida Peti- Anëtar- (Specialist Arsimi)

Eneda Shehi- Anëtar- (Përfaqesues i kshillit Bashkiak)

Eni Telhaj- Anëtar (Specialist i sektorit te Statistikave)

